

A. MUSA  
NR. Prot 525  
Df 07/06/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr. 16 Datë 11/05/2017

**Për miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor, lumi Seman pranë ures së Belines (krahu djathtë) Bashkia Fier për ujë teknologjik nga subjekti "Bankers Petroleum Albania Ltd"**

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 41, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumentave shoqeruse, afatit të vlefshmerise, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujorë si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujorë"  
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

**Miratimin e lejes për shfrytëzimin të burimit ujor, lumi Seman pranë ures së Belines (krahu djathtë) Bashkia Fier për ujë teknologjik nga subjekti "Bankers Petroleum Albania Ltd"**

Kordinatat e rezervës ujore ku do të merret ujë janë :

X = 38 60 40.88

Y = 45 12 533.57

Z = 11 m

Me prurja e burimit ujorë është  $Q_{min} = 17.7 \text{ m}^3/\text{sek}$   
Sasia që jepet në përdorim është  $Q = 69.44 \text{ l/sek}$  me kushtin që përrua të mbeten të pa prekur 30% e sasisë së ujit për prurje ekologjike.

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI AUB SEMAN

Isuf Myrtaj



NENKRYETARI I KBU  
SEMAN  
Gentian Nushi

